



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

R A P O R T

Për
veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2012

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tiranë,

Tel./Fax.

+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail

infosec@cec.org.al



Tiranë, Shkurt 2013



***E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar deputetë,***

Në mbështetje të nenit 21, pika 13, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, kam nderin që, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, t'iu paraqes raportin për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2012.

Me konsideratë,

Lefterije LLESHI (LUZI)

**KRYETARE
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.

+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail

infosec@cec.org.al





PASQYRA E LËNDËS

	fq
HYRJE.	4
I. VEPRIMTARIA E PËRGJITHSHME E KQZ-SË	6
I.1 Burimet njerëzore.	6
I.2 Mendime në funksion të zbatimit të rekomandimeve të Raportit përfundimtar të MVZ të OSBE/ODHIR-it për reformën zgjedhore.	7
I.3 Raporti dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.	8
I.4 Aktivitete të KQZ-së në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare.	9
I.5 Buxheti i KQZ-së për vitin 2012.	11
I.6 Auditimi i fondeve të partive politike.	12
II. Kërkesë për Referendum të Përgjithshëm	14
II.1 Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, i paraqitur nga një grup nismëtarësh, për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	14
II.2 Shqyrtimi i kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	14
III Plotësimi i vakancave të njoftuara nga Kuvendi	16
IV Konstituimi i KQZ	17
V. VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN 2013	17
V.1 Përgatitja e dokumentacionit për projektet SEN dhe SEV.	17
V.2 Plani orientues i veprimeve	19
V.3 Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2012, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013	19
V.3.1 Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013	19
V.3.2 Miratimi i krijimit të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013.	20
V.3.3 Për emërimin e auditëve teknikien	22
V.3.4 Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV, që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013.	22
V.3.5 Miratimi i strukturës së personelit shtesë.	23
V.3.6 Përdorimi i kamerave regjistruese dhe monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave, në Zgjedhjen për Kuvendin 2013.	24
V.3.7 Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit, për zgjedhjet për kuvend, 23 Qershor 2013.	24

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Bldv. Deshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Hyrje

**E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,**

Ky është raporti i parë vjetor që trupa e re e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e zgjedhur në muajin tetor të vitit 2012, paraqet përpara këtij Kuvendi, të nderuar.

Nëpërmjet këtij raporti, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve synon të paraqesë, në përmbushje të detyrimit ligjor institucional, në mënyrë të detajuar veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2012, por njëherazi synon të sjellë në vëmendje të gjithë aktorëve dhe faktorëve politikë, nevojën për të bashkëpunuar dhe mirëkuptuar çdo problem të evidentuar, me qëllim shfrytëzimin e të gjithë potencialeve, në funksion të arritjes së standardeve më të larta të zgjedhjeve demokratike, të cilat nuk janë dhe nuk mund të kuptohen vetëm si sfidat e një institucioni, e një subjekti politik, por si sfidë e të gjithë kombit, përmbushja e së cilës, sikundër është theksuar nga faktori ndërkombëtar, është test i rëndësishëm e vendimtar për të ardhmen evropiane të Shqipërisë.

Njëherazi, duke respektuar pavarësinë dhe paanshmërinë e institucionit që drejtoj, do të respektoj dhe do të jem shumë e vëmendshme ndaj çdo mesazhi tuajin, qoftë si përfaqësues të popullit, qoftë si liderë të partive politike. E ardhmja evropiane e Shqipërisë, si ëndërr që të gjithë shqiptarët dëshirojnë ta materializojnë sa më shpejt, është padyshim prioritet i përgjegjësive tona, prandaj mirëpresim çdo sugjerim tuajin për të ngritur në standardet e kërkuara, punën tonë.

Megjithëse viti për të cilin paraqitet ky raport, përkon me një vit jo-zgjedhor, ka qënë një vit i ngarkuar në veprimtarinë e institucionit, kjo në kuadër të ndryshimeve dhe risive të kuadrit ligjor specifik për zgjedhjet, Kodit Zgjedhor.

Trupa e re e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u zgjodh nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 11 tetor 2012, dhe menjëherë filloi punën për ushtrimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm të plotë, të përgjegjësive të saj, e ndërgjegjshme për sfidat në punën e saj dhe e vendosur për t'i shërbyer vetëm ligjit, forcimit të shtetit, konsolidimit të demokracisë që ngrihet dhe mbështetet fort tek themeli i votës dhe respektimi i saj, për t'i dëshmuar mbarë opinionit publik dhe faktorëve ndërkombëtarë se ky institucion është

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infocec@cec.org.al





garant i respektimit të së drejtës themelore kushtetuese të shtetasve në këtë vend: të drejtës për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur!

Reformimi i legjislacionit zgjedhor, futja për herë të parë e teknologjive në procesin e numërimit dhe identifikimit të zgjedhësve, kërkon jo vetëm impenjim dhe punë më të madhe të KQZ-së, si institucioni më i lartë i ngarkuar nga ligji për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, por njëherazi bashkëpunim më të ngushtë dhe mirëkuptim të të gjithë aktorëve dhe faktorëve në vend, qofshin këto parti politike, grupe interesi, dhe po aq edhe të shoqërisë civile.

Fokus i rëndësishëm në punën tonë, janë gjithashtu raportet e OSBE ODHIR si ato për zgjedhjet vendore të vitit 2011, zgjedhjet e 2009, mbi të cilat është synuar të ndërtohet strategjia në të gjitha aspektet për përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, duke evidentuar dhe mësuar edhe nga eksperiencat e zgjedhjeve të kaluara, në vlerësim të përvojave pozitive të grumbulluara.

Përvojat e fituara në proceset zgjedhore të kaluara, rekomandimet e OSBE/ODHIR, asistenca e organizmave ndërkombëtarë, do të vihen në shërbim të zgjedhjeve për për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, në funksion të zhvillimit dhe *përmirësimit të krejt infrastrukturës zgjedhore, në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor.*

Realizimi i pritshmërive, garantimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike, mbetet sfida jonë, me mbështjetjen dhe mirëkuptimin tuaj, me besim për arritjen e standardeve të gjithëpranuara e gjithëvlerësuar !

Ju faleminderit!

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.

+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail

infosec@cec.org.al





I. Veprimtaria e përgjithshme e KQZ-së

I.1 Burimet njerëzore

Në vizionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, edhe për vitin 2012, prioritet i rëndësishëm ka qënë dhe vazhdon të jetë konsolidimi i një administrate zgjedhore të qëndrueshme, nëpërmjet zbatimit me përpikmëri të procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor zgjedhor, forcimit të kapaciteteve të saj nëpërmjet trajnimit të thelluar dhe të vazhdueshëm, kryesisht në fushën e përmirësimit të aftësive menaxheriale dhe drejtuese. Njëkohësisht prioritet jo pak i rëndësishëm gjatë vitit që lamë pas, ishte dhe rritja e përgjegjshmërisë së nëpunësve të administratës zgjedhore në ushtrimin e funksioneve të tyre, proces ky që ndër të tjera adresoi delegimin e vendimmarrjes sa më pranë pozicionit përgjegjës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2012, ushtroi veprimtarinë funksionale me këtë kontigjent burimesh njerëzore: 7 anëtarë dhe 48 punonjës organik të administratës, nga të cilët 30 punonjës të administratës trajtohen me statusin e nëpunësit civil dhe 18 punonjës të administratës trajtohen si punonjës mbështetës.

Një nga 12 prioritetet themelore, sipas Opinionit të Komisionit Evropian të vitit 2010, rekomandimi 6, adreson administratën publike, duke vënë theksin tek shërbimi civil. Në këtë kontekst vlerësojmë se për vitin raportues, si orientim permanent të punës së institucionit, ka qënë rritja e profesionalizmit, emërimeve dhe promovimeve bazuar në transparencë dhe merita, nëpërmjet zbatimit me konsekuencë të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi Nëpunësit Civil".

Më konkretisht për vitin 2012:

1. Procedurat e rekrutimit të nëpunësve të Administratës së KQZ në periudha të ndryshme kohore, janë zbatuar me rigorizitet dhe janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ligji për shërbimin civil (neni 13) dhe VKM nr.231, datë 11.05.2000, "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës".
2. Procedurat për vlerësimin vjetor të punës të çdo punonjësi civil brenda afateve ligjore, për hartimin e formularëve dhe përgatitjen e përshkrimeve të punës, për secilin pozicion pune, si dhe procesi i organizimit të dosjeve dhe regjistrimit të personelit, janë kryer në zbatimin korrekt të kërkesave të ligjit për shërbimin civil.
3. Pikësynimi për përsosjen e vazhdueshme të punës kërkon dhe staf të kualifikuar e të trajnuar. Në këtë kuptim procesi i trajnimit të të gjithë nëpunësve civilë

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





është zhvilluar periodikisht, sipas temave të parashikuara nga ITAP, në përshtatje me pozicione pune të caktuara. Vlen të përmendet një nga temat e zhvilluara si ajo e mbrojtjes së të dhënave personale, e cila i vjen në ndihmë administratës së KQZ-së në aplikimin e përdorimit të teknologjisë së verifikimit dhe regjistrimit të pjesëmarrjes së zgjedhësve në ditën e votimit (SEN).

Gjithashtu në reflektim të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, për sa i takon aplikimit të procesit SEV dhe SEN por jo vetëm, janë bërë përgatitjet dhe janë ndërtuar strategjitë, ku vëmendje e veçantë ju kushtohet trajnimit specifik të administratës së KQZ-së dhe komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta në këtë drejtim. Pjesëmarrja e nëpunësve të administratës në aktivitete të zhvilluara lidhur me proceset zgjedhore, si dhe vëzhgimi i disa proceseve zgjedhore jashtë Shqipërisë, i shërben jo vetëm kualifikimit të saj por dhe eksperiencës së fituar në këtë fushë.

Çertifikimin e kësaj pune të cilësishme e paraqiti edhe Komisioni i Shërbimit Civil, në projekt-raportin e paraqitur në Muajin Dhjetor 2012 adresuar KQZ-së, lidhur me kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të sipërcituara, ku vlerësoi zbatimin korrekt të procedurave ligjore të përcaktuara në ligjin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Për sa i takon strukturës organike aktuale të institucionit, nisur dhe nga fakti që kjo strukturë është miratuar kohë më parë daljes së VKM nr.474, datë 16.06.2011, "Për përcaktimin e standarteve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", Komisioni i Shërbimit Civil, konstatoi se ka nevojë për një rishikim të kësaj strukture, me qëllim që të implementohen standartet e reja, si në drejtim të organizimit të njësive të strukturës (drejtori dhe sektorë), ashtu dhe në drejtim të pozicioneve të punës që nevojiten për të ndërtuar këto njësi.

Procesi zgjedhor i radhës është një proces shumë i rëndësishëm dhe mjaft kompleks, i cili në vetevete kërkon pikë së pari burime njerëzore të përshtatshme, të cilët tashmë i kemi, për më tepër kemi kapacitete nëpunësish profesionistë, të qëndrueshëm, transparent dhe të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të cilët na bëjnë të besojmë në mirëorganizimin dhe mirëmenaxhimin e krejt infrastrukturës zgjedhore.

I.2 Mendime në funksion të zbatimit të rekomandimeve të Raportit përfundimtar të MVZ të OSBE/ODHIR-it për reformën zgjedhore.

Në kuadër të punës për reformën zgjedhore, komisioni Parlamentar për reformën zgjedhore, kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucioni përgjegjës për

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





administrimin e zgjedhjeve, mendime për përmirësimin apo ndryshimin e praktikave dhe procedurave që mund të përmirësojnë performancën e KQZ-së dhe administrimin e procesit në tërësi.

Dokumenti rekomandues u bazua në mendime teknike, të cilat synonin rregullimin e praktikave zgjedhore dhe shmangien e problematikave të cilat lidheshin me hapësira dhe përcaktime jo-koherente që kishin efekt të drejtpërdrejtë në standardet dhe mirë administrimin e një procesi zgjedhor.

Nisur nga ky qëllim bazë, rekomandimet prekën kryesisht çështje që lidhen me zonat e administrimit zgjedhor dhe qendrat e votimit, organizimin dhe funksionimin e komisioneve të nivelit të dytë dhe të tretë (KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të), procesin dhe afatet e regjistrimit të subjekteve politike dhe ndikimi i tyre në përgatitjen e fletës së votimit, procedurat për vlerësimin e votave të hedhura në kutinë e gabuar, përmirësimi i procedurave për hapjen dhe mbylljen e votimit në qendrën e votimit, administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zgjedhor, përmirësimi i infrastrukturës për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë, financimin e subjekteve zgjedhore, si dhe afatet që lidhen përgjithësisht me periudhën zgjedhore.

Çështjet e ngritura dhe rekomandimet e bëra, u bazuan në problematikat e konstatuara gjatë dy proceseve të fundit zgjedhore, ato për Kuvend të vitit 2009 dhe për organet e qeverisjes vendore 2011.

Vlen për të cilësuar se KQZ ka gjetur vëmendjen dhe interesin e komisionit parlamentar për reformën zgjedhore për të gjitha çështjet dhe problematikat specifike, sidomos ato në lidhje me hapësirat ligjore dhe mungesën e koherencës së kodit zgjedhor në referim të administrimit të procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore.

Në miratimin e amendamenteve të kuadrit ligjor zgjedhor, një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të bëra nga KQZ, si dhe praktika e ndjekur nga KQZ gjatë administrimit të procesit të fundit zgjedhor, tashmë janë pasqyruar në ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

I.3 Raporti dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi kontroll gjatë muajve Janar, Shkurt dhe Mars 2012 në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me objekt: "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomike financiare", për periudhën nga 01.01.2010 deri më 31.12.2011. Kryesisht vëmendje të posacme, KLSH i kushtoi çështjeve që lidhen me administrimin dhe menaxhimin financiar dhe të përdorimit të fondeve publike për arritjen e objektivave të institucionit në zbatim të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", programimit dhe zbatimit të buxhetit të institucionit, administrimit të pronës publike, materialeve zgjedhore dhe

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





procedurat e prokurimeve të fondeve publike. Kontrolli u krye duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë, por edhe duke u këshilluar dhe ballafaquar me stafin drejtues, por edhe atë administrativ të KQZ-së.

Në përfundim të auditimit, në funksion të përmirësimit të gjendjes, u rekomanduan masa për të cilat janë ndërmarre hapat e mëposhtme:

Masa organizative, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me veprime të cilat duhet të kryejë KQZ-ja, me qëllim përdorimin sa më me efektivitet të fondeve buxhetore. Kështu, nga KLSH u konsiderua se meqënëse shpenzimet për energji elektrike zënë 16.5% të shpenzimeve operative, duhen marrë masa që KQZ të ketë një linjë të posaçme të pavarur nga ajo e DSHQ-së. Për këtë është marrë miratimi nga DSHQ, dhe ka filluar komunikimi me OSSH.

Prokurimi i shërbimit të ruajtjes me roje private, sipas rekomandimit të KLSH, duhet bërë i përqëndruar. Kjo do të vleresohet në momentin e prokurimit të këtij shërbimi në vazhdimësi.

Me VKM të posaçme një magazinë e bazës materiale në Lundër, është kaluar nga rezervat e shtetit në pronësi të KQZ-së. Për këtë magazinë duhet bërë rivleresimi me çmimet e tregut, me ekspertë privatë, dhe më pas duhet kontabilizuar konform vlerës që do të nxjerre eksperti. Ka filluar puna për realizimin e këtij rekomandimi me vënien në dispozicion të fondeve nga buxheti i shtetit.

Në vite janë krijuar shuma debitore nga partitë politike, për shkak të moskthimit të shumave të përfituara për qëllime të fushatave elektorale. Sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, shumat e dhëna nga KQZ paradhënie, me daljen e rezultatit përfundimtar, nëse partia nuk ka arritur rezultatin që parashikon Kodi Zgjedhor duhet të kthehen. Këto detyrime janë evidentuar dhe ka filluar puna për arkëtimin e tyre.

Janë rishikuar limitet telefonike për anëtarët e KQZ-së, me qëllim respektimin e tavanit të përcaktuar në aktet nënligjore, 2% të shpenzimeve operative.

Gjithashtu në raportin përfundimtar të KLSH-së janë lënë edhe dy masa zhdëmtimi për plotësimin e të cilave janë marë masat përkatëse. Për njerin rast është nxjerrë urdhër zhdëmtimi dhe për rastin tjetër ka filluar komunikim shkresor me subjektin privat për arkëtimin e shumës së evidentuar nga KLSH.

1.4 Aktivitete të KQZ-së në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare.

Faktor i rëndësishëm për konsolidimin e rolit profesional dhe teknik të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, ka qenë dhe mbetet asistenca dhe konsulenca e organizmave ndërkombëtarë me eksperiencë në organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Meqënëse viti 2012 nuk ishte vit zgjedhor, bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare brenda vendit ka vazhduar intensivisht, sidomos në funksion të përgatitjeve të zgjedhjeve për Kuvend të datës 23 Qershor 2013.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





E një rëndësie të veçantë ka qënë pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për trajtimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet, sikundër edhe eksperiencat e përftuara nga ndjekja e zhvillimit të proceseve zgjedhore në vende të BE-së, konkretisht:

- Pjesëmarrja në seminarin "Financimi i Partive Politike gjatë fushatës zgjedhore", organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Gjeorgjisë dhe në mbështetje të UNDP;
- Seminari dy ditor në Tiranë në kuadër të marrjes së Presidencës së Kryesisë së Komitetit të Ministrave të KiE-së, i cili u realizua në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Komisionin e Venecias që u mbajt në datat 2-3 Korrik 2012, me temë "Trashëgimia Zgjedhore Evropiane: Dhjetë Vjet Të Kodit Të Praktikës Së Mirë Për Çështjet Zgjedhore";

Ky aktivitet kishte për objektiv kryesor, krijimin e një hapsire juridike të përbashkët me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit midis shteteve në fushën zgjedhore. Pjesëmarrja i një numri të madh e përfaqësuesve të Komisionit të Venecias, ekspertëve të vendeve të tjera për çështjet zgjedhore, përfaqësuesve të instancave më të larta të shtetit shqiptar, anëtarëve dhe administratës së KQZ-së, si pjesë integrale e këtij seminari, bëri që ky aktivitet të ishte një mundësi shumë e mirë jo vetëm për të promovuar arritjet e Shqipërisë në fushën e zgjedhjeve, por dhe për të evidentuar lidhjen e ngushtë të administratës zgjedhore shqiptare me udhrrëfyesin zgjedhor, Kodin e Praktikave të Mira, sikundër diskutimet, shkëmbimi i opinioneve dhe eksperiencave i shërbyen thellimit në kuptimin e vlerave të dokumentit bazë të zgjedhjeve që Këshilli i Europës ka përpunuar, potencialit të jashtëzakonshëm dhe perspektivës që ai hap për arritjen e standartit më të lartë zgjedhor në Shqipëri.

- Vizita studimore në Republikën e Francës, me rastin e zgjedhjeve Presidenciale, duke u përqëndruar në tematikat "Organizimi i zgjedhjeve dhe roli i administratës shtetërore" dhe "Votimi Elektronik dhe Procesi i Numërimit".
- Në bashkëpunim me përfaqësinë e Këshillit të Evropës në Tiranë është mundësuar organizimi i dy vizitave studimore respektivisht " Vëzhgimi i Procesit Zgjedhor në Zvicër" në datat 22-25 nëntor 2012, si dhe vizita studimore në Strazburg me ekspertët e çështjeve zgjedhore në Këshillin e Evropës në lidhje me përgatitjen e procesit para zgjedhor, kuadri ligjor dhe zbatimi i tij për zgjedhjet e ardhshme të datës 23 qershor 2013. KQZ u përfaqësua në këto dy vizita studimore nga kryetarja dhe anëtarët e KQZ-së.
- Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, janë intensifikuar komunikimet dhe kontaktet me të gjitha organizmat ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë me qëllim identifikimin e fushave të bashkëpunimit në funksion të mirëadministrimit të procesit zgjedhor.

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Gjatë kësaj periudhe janë organizuar dhe zhvilluar takime të vazhdueshme ndërmjet Kryetares së KQZ-së dhe përfaqësuesve më të lartë të OSBE, KE-së, KiE-së, USAID, TIKA etj. Në këto takime është shprehur dëshira e mirë e bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe faktorit ndërkombëtar si në atë teknike dhe financiare.

- Gjithashtu me iniciativë të pranisë së OSBE-së dhe mbështetjen e KQZ-së, në muajin nëntor është ngritur dhe mblidhet rregullisht Election Working Group, një grup pune, i cili ka për qëllim identifikimin e nevojave të KQZ-së, koordinimin e pjesëmarrësve në ofrimin dhe dhënien e asistencës parazgjedhore për shoqërinë civile (grupeve të interesit) të angazhuar në mbarëvajtjen dhe vëzhgimin e zgjedhjeve si ofrimin e asistencës profesionale për KQZ-në. Ky grup pune ofron asistencës profesionale në drejtim të përmirësimit të strategjise dhe metodologjisë që harton dhe zbaton KQZ në fushat e trajnimit të komisionerëve dhe edukimit të zgjedhësve.
- I një rëndësie të veçantë ka qënë bashkëpunimi i sukseshëm i KQZ-së me UN Women. Ky bashkëpunim i cili u jetësua me marrëveshje dypalëshe mes Njësisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women) dhe KQZ-së për inicimin e zbatimit të një projekti të përbashkët për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e kuadrove të përshtatshme të politikave që garantojnë transparencë dhe përgjegjshmëri për barazinë gjinore në kuadrin e programit të bashkëpunimit të Qeverisë Shqiptare dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Synim kryesor i projektit ishte trajtimi i çështjeve gjinore në lidhje me zgjedhjet, me qëllim rritjen e njohurive dhe kompetencave për: (i) trajtimin e çështjes së barazisë gjinore në sistemet elektorale, dhe (ii) përpilimin e strategjive të medias me fokus të veçantë tek çështjet gjinore, duke synuar gratë votuese dhe probleme të votimit familjar. Ky bashkëpunim ndikoi sukseshëm, jo vetëm në kuadër të realizimit të qëllimit të projektit, por gjithashtu ndikoi që administrata e KQZ-së, e angazhuar për zbatimin e tij, të konsolidojë standardet e eficiencës, kompetencave profesionale dhe integritetit.

1.5 Buxheti i KQZ-së për vitin 2012

Për vitin 2012, KQZ-së ju vunë në dispozicion 91,106 mijë lekë, në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" për shpenzimet e administratës për paga dhe sigurime, shpenzime për mallra dhe shërbime, si edhe për shpenzime kapitale. Në zbatim të aktit normativ nr.6, date 12.12.2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10487 datë 05.12.2012 "Për procedurat standarte të buxhetit", buxheti i KQZ-së u pakësua me 6,650 mije lekë në zërin " paga dhe sigurime". Duke qënë se ky pakësim u bë bazuar në realizimin e buxhetit, kjo nuk ndikoi në plotësimin e detyrimeve ligjore lidhur me këtë zë të shpenzimeve.

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të ligjit 74/2012 datë 19.07.2012 "Për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", pesë antarëve të KQZ-së ju ndërprejnë mandatet. Në zbatim të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, si edhe me kërkesë të KQZ-së, Ministria e Financave vuri në dispozicion shumën e nevojshme për shpërblimin e menjëhershëm të këtyre antarëve, në masën që përcakton ligji.

Në programin "Administrim i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore" për vitin 2012, me ligjin "për buxhetin e vitit 2012", KQZ-se nuk ju akorduan fonde sepse viti 2012 nuk ishte vit në të cilën ishin parashikuar të mbaheshin zgjedhje.

Megjithatë, me kërkesë të KQZ-së, bazuar në nenin 100 të Kushtetutes, ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si edhe ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me VKM nr. 760, datë 7.11.2012 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për KQZ-në, për pagesën e eksperteve kontabël të licensuar për shërbimin e auditimit të fondeve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet vendore të datës 8 maj 2011", në programin "administrim i zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore", u shtua fondi prej 5 milion lekësh.

Këto fonde u përdorën për pagesën e ekspertëve që audituan fondet e subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet vendore të datës 8 maj 2011".

Në zbatim të buxhetit të akorduar u realizuan procedurat prokuruese për sigurimin e bazës materiale për funksionim e institucionit, konform legjislacionit në fuqi të prokurimeve publike.

Buxheti i KQZ-së për vitin 2012 jepet në tabelën në Aneksin 1.

1.6 Auditimi i fondeve të partive politike

1.6/1 Auditimi i fondeve të përfituara nga partitë politike për fushatën zgjedhore 2011

Procesi i auditimit të fondeve të përfituara dhe të përdorura nga subjektet politike gjatë fushatës elektorale, filloi me daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve vendore të datës 8 maj 2011. Në mbështetje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.1232, datë 07.11.2011, emëroi me short 23 ekspertë kontabël të licensuar për auditimin e 161 subjekteve zgjedhore, nga të cilat:

- ✚ 55 parti politike,
- ✚ 62 kandidatë për këshillat të propozuar nga zgjedhësit,
- ✚ 44 kandidatë për kryetarë të propozuar nga zgjedhësit.

Bazuar në vendimin e mësipërm, KQZ lidhi kontratat me 22 ekspertë kontabël të licensuar, të cilët kanë audituar dhe dorëzuar pothuajse tërësisht raportet për subjekte

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





e audituara. Këto raporte u shqyrtuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në përgjithësi raportet e auditimit u përgatiten konform formatit të miratuar nga KQZ me vendimin nr.3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standartizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertët kontabël".

Në përfundim KQZ me vendimin nr.8, date 9.05.2012, vendosi të publikojë raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet vendore 2011. Këto raporte janë të aksesueshme nga publiku në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

1.6/2 **Auditimi i fondeve vjetore të partive politike 2011**

Në mbështetje të nenit 23/2, pika 2 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin ligjor të emërojë me short për çdo subjekt zgjedhor, ekspertë kontabël të licencuar të cilët do të auditojnë fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik pararendës.

Sipas shkresës nr. 145/2, datë 27.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Parti Politike të regjistruara në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë 120, të cilat në përmbushje të detyrimit ligjor, duhet të auditoheshin për fondet e përftuara dhe të shpenzuara për vitin 2011 nga ekspertë kontabël të licencuar.

KQZ i kërkoi Institutut të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar listën e ekspertëve të cilët plotësonin kushtet e parashikuara në dispozitat e ligjit për partitë politike. Me shkresën nr.5/1, datë 17.01.2012, Instituti i Ekspertëve të Akredituar i dërgoi KQZ-së listën e përbërë nga 158 ekspertë kontabël të licencuar të cilët plotësonin kriteret e kërkuara. Në mbështetje të gërmës "c", "d" dhe "e", të nenit 4 dhe nenit 5, të udhëzimit nr. 8, datë 25.03.2009, KQZ i kërkoi ekspertëve kontabël të përfshirë në listën e përzgjedhur të depozitonin në KQZ kërkesën për pjesëmarrje në short, si dhe deklaratat personale për plotësimin e kriterëve të parashikuara në dispozitat sipërcituar. Në përfundim të këtyre procedurave, u depozituan 45 kërkesa për pjesëmarrje në short dhe nga verifikimi i tyre rezultoi se të gjitha këto kërkesa i plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 23/2, pika 1, të ligjit për partitë politike dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 8, datë 25.03.2009.

Shorti për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar u organizua duke marrë pjesë 120 parti politike dhe 45 ekspertë kontabël të licencuar. Më datë 04.04.2012 KQZ, në prani të përfaqësuesve të partive politike, ekspertëve kontabël dhe mediave, u zhvillua, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 8, datë 25.03.2009, shorti për emërimin e ekspertit kontabël i cili do të auditonte fondet e përftuara dhe të shpenzuara të partive politike përkatëse.

Nga 45 ekspertë kontabël të licencuar, të emëruar për auditimin e 120 partive politike, vetëm 1/3 e tyre kanë përmbushur detyrën zyrtare në përgjigje të detyrimit që rrjedh

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





nga kontrata e lidhur me KQZ-në, pjesa tjetër i komunikonte KQZ-së pamundësinë e kryerjes së misionit për shkak të mos gjetjes së selisë së partisë në adresën e deklaruar në gjykatë.

Raportet e paraqitura për auditim të fondeve vjetore 2012, janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.

II. Kërkesë për Referendum të Përgjithshëm

II.1 Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, i paraqitur nga një grup nismëtarësh, për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Një grup prej 16 nismëtarësh paraqitën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në fund të vitit 2011 kërkesën për fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumit të përgjithshëm.

Në mbështetje të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 i ndryshuar, KQZ me vendimin nr. 1236, datë 22.12.2011 vendosi miratimin e modelit të fletës-tip dhe pajisi grupin nismëtar me numrin e duhur të tyre, për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve.

Më pas nismëtarët e këtij grupi, depozituan më datë 13.03.2012 në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumentacionit në KQZ, kërkesën së bashku me nënshkrimet e zgjedhësve për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Nisur nga fakti se dokumentacioni i paraqitur bashkëlidhur kërkesës ishte voluminoz dhe nuk mund të merrej në dorëzim brenda ditës, KQZ pranoi kërkesën e nismëtarëve për dorëzimin fizikisht të dokumentacionit në ambjentet e institucionit, duke e siguruar atë brenda kutive të votimit, ku këto të fundit u mbyllën me kode sigurie. Ky veprim u krye me procedura krejtësisht transparente dhe në bashkëpunim të plotë midis palëve (nismëtarëve dhe specialistëve të institucionit). Në përfundim të kësaj procedure, filloi përpunimi protokollar i dokumentacionit të dorëzuar. Nisur nga volumi i madh i dokumentacionit, ky proces kërkoi një angazhim maksimal për hapjen, numërimin, numërtimin dhe vulosjen e çdo fletë të paraqitur si pjesë përbërëse e materialit.

II.2 Shqyrtimi i kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e një pjese të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Kërkesën për referendum të përgjithshëm, nismëtarët si depozitues të nënshkrimeve të zgjedhësve e bazuan në nenin 150, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në nenin 126, pikat 2, 3 dhe 4, dhe nenin 127, të pjesës së nëntë të Ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





KQZ, në përputhje me afatin kohor, përcaktuar në nenin 128 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", brenda 90 ditëve, duke filluar nga data 30.03.2012, verifikoi nënshkrimet dhe saktësinë e dokumentave të identifikimit të zgjedhësve, duke u bazuar mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur. KQZ bëri verifikimin e dokumentacionit me objekt:

- + Afatin e dorëzimit të kërkesës në KQZ;
- + Verifikimin nëse nënshkrimet e zgjedhësve ishin depozituar në Fletën-Tip të miratuar nga KQZ;
- + Verifikimin e plotësimit të të dhënave të kërkuara në fletën tip;
- + Numërimin e nënshkrimeve të depozituara nga zgjedhësit;
- + Numërimin e të gjitha kopjeve të dokumentave të identitetit të zgjedhësve nënshkrues;
- + Verifikimin e përputhshmërisë së të dhënave të zgjedhësve depozituar bashkë me nënshkrimin në Fletën-Tip me të dhënat në dokumentin e identifikimit;
- + Verifikimin e faktit nëse nënshkruesit në fletën-tip, ishin zgjedhës në momentin e depozitimit të kërkesës nëpërmjet verifikimit në dokumentin e identitetit të moshës së nënshkruesve.

Grupi nismëtar rezultoi se depozitoi gjithësej **3798** Flet-Tip në të cilat janë **65649** shtetas që kanë nënshkruar dhe **64655** kopje të kartave të identitetit.

Në vijim të verifikimit të nënshkrimeve dhe dokumentacionit përkatës, me sy të lirë u krijua dyshimi se, shumë emra të zgjedhësve dhe nënshkrimet përkatëse të tyre ishin të plotësuar nga e njëjta dorë.

Në këto kushte KQZ, mbi bazën e një përzgjedhje rastësore nga qarqe të ndryshme, dërgoi një pjesë të Modeleve-Tip pranë Institutit të Policisë Shkencore, për një verifikim nga organi i specializuar, të emrave dhe nënshkrimeve të zgjedhësve, për të cilat kishte lindur dyshimi i falsifikimit të dokumentacionit. Sipas Institutit të Policisë Shkencore rezultoi se rreth 70% e nënshkrimeve, nga kampionët të cilët u dërguan për ekspertim, ishin të falsifikuara, të bëra nga e njëjta dorë.

Në përfundim të verifikimit të gjithë dokumentacionit të dorëzuar, KQZ konstatoi se, numri i zgjedhësve të cilët kishin nënshkruar në formularin-tip Model 01-F është **65649**. Duke hequr nga ky numër, numrin e nënshkrimeve me parregullsitë e vërtetuara si më sipër, numri i zgjedhësve nënshkrues për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm, rezultonte përsëri më i madh se ai i kërkuari ligjërisht, 50.000 mijë.

Në referim të përcaktimeve të nenit 129 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", KQZ, kërkesat për referendum të përgjithshëm, ia përcjell Presidentit të Republikës dhe Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 119 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ku në pikën 6 të tij, përcaktohet se:

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





"...kërkesat për referendum, që nuk kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat, brenda datës 15 mars të çdo viti, pavarësisht se kur janë paraqitur, shtyhen deri në vitin pasardhës".

Në vështrim të përcaktimeve të dispozitave sipërcituar, si dhe në vlerësim të faktit se kërkesa e paraqitur nga grupi nismëtar, për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqzimin e një pjese të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" nuk i kishte përfundur procedurat brenda datës 15 mars të vitit 2012, përcjellja e saj në Gjykatën Kushtetuese u krye nga KQZ më 3 janar 2013, dhe në të njëjtën datë u njoftua Kuvendi i Shqipërisë dhe Kryeministri.

III Plotësimi i vakancave të njoftuara nga Kuvendi

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ për krijimin e vakancës dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, rregjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë vitit 2012, Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar KQZ për katër raste të krijimit të vakancave si pasojë e ndërprerjeve të mandateve të katër deputetëve. Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

✚ Më datë 13.01.2012 me vendimin nr. 2 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë" vendosi t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste Qarku Durrës, z. Gjon Hill Bardhi.

✚ Më datë 17.04.2012 me vendimin nr. 7 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë" vendosi t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste Qarku Durrës, z. Edison Perikli Konomi.

✚ Më datë 19.06.2012 me vendimin nr. 9 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në Qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë" vendosi t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike Qarku Tiranë, z. Vath Qerim Tabaku.

✚ Më datë 26.10.2012 me vendimin nr. 12 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të radhës të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi vendosi t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë për Qarkun Tiranë, z. Auron Isa Tare.

IV. Konstituimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Më datë 18 tetor 2012 Kryetarja dhe anëtarët e KQZ bënë betimin në Kuvendin e Shqipërisë dhe menjëherë filluan detyrën duke patur dhe sfidën me kohën e kufizuar për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin 2013.

Në mbledhjen e datës 26.10.2012, KQZ-ja, zhvilloi votimin, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 16, pika 2 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të KQZ-së ndërmjet dy anëtarëve të propozuar nga Partia Socialiste, Zj. Albana Shtylla dhe Z. Denar Biba. Në përfundim të votimit z. Denar Biba u zgjodh zëvendëskryetar i KQZ-së.

Kodi Zgjedhor, i ndryshuar, në nenin 183 përcakton përsëritjen pjesore të KQZ-së. Për realizimin e kësaj përtëritje pjesore, dy nga anëtarët e KQZ-së të propozuar respektivisht nga shumica parlamentare dhe nga opozita parlamentare, të zgjedhur sipas pikës 1 të nenit 14 të Kodit, e ushtrojnë mandatin e parë për tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Përcaktimi i anëtarëve të KQZ-së, të cilëve do t'u ndërpritet mandati para kohe, u realizua me short, i cili u zhvillua nga KQZ në seancë publike.

KQZ, me vendim të ndërmjetëm miratoi rregullat për organizimin e shortit dhe në seancën publike të datës 1.11.2012, zhvilloi shortin, për përcaktimin e anëtarëve të KQZ-së i cilët do të ushtrojnë mandatin e parë, për një periudhë tre vjeçare, me qëllim përtëritjen pjesore të KQZ-së.

Në përfundim të zhvillimit të shortit, rezultoi se Z. Ilirjan Muho, dhe Zj. Albana Shtylla, do të ushtrojnë mandatin e parë si anëtarë të KQZ-së për një periudhë tre vjeçare.

V. Veprimtaria e KQZ-së, për përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvendin, të datës 23 Qershor 2013.

V.1 Përgatitja e dokumentacionit për projektin SEN dhe SEV

Administrata e KQZ-së që në muajin shtator hartoi një plan veprimi për përgatitjen e dokumentacionit për dy projektet e reja të parashikuara në Kodin Zgjedhor, që përdorin teknologjinë e informacionit për zgjedhjet 2013, atë të sistemit elektronik të numërimit (SEN) dhe sistemit elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve ditën e votimit (SEV). Deri në datën 18 tetor 2012 u përgatitën kërkesat bazë për hartimin e detyrës së projektim-zbatimit për të dy projektet, SEN dhe SEV.

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tiranë,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Në veprimet e para të Trupës së re të KQZ-së ishte konsiderimi për zhvillimin e këtyre projekteve, si dhe diskutimi periodik i tyre me grupin e punës për vazhdimësinë e këtij procesi.

Në planin e veprimit të administratës së KQZ-së, në kuptim edhe të legjislacionit për prokurimet, parashikohej që specifikimet teknike do të bëheshin nga një kompani e specializuar duke u tenderuar. Referuar limitimit të kohës në dispozicion për përgatitjen e këtyre specifikimeve (vetëm procedura e prokurimit "shërbim konsulence" për projektet teknik kërkonte minimuni 60 ditë) për të kapur afatet kohore të duhura, pasi u dëgjuan dhe u diskutuan nga KQZ kërkesat bazë për të dy projektet, u pa e arsyeshme që administrata e KQZ-së të përgatiste edhe dokumentacionin teknik, duke synuar të shkohej në një projekt-buxhet.

Në rrugë zyrtare KQZ i kërkoi Kryeministrisë dhe Ministrisë së Brendshme caktimin e personave që do të jepnin konsulencë teknike për projektet, ashtu siç parashikon Kodi Zgjedhor, njëkohësisht Ministrisë së Brendshme ju bë me dije, që në grupin e punës të ngritur për SEV-in do të kishte përfaqësuesin e vet, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Në fillim të muajit nëntor administrata e KQZ-së përgatiti dhe paraqiti në mbledhje informale të KQZ-së specifikimet teknike dhe projekt-buxhetin për të dy projektet. Dokumentacioni përkatës, përfshi dhe kërkesat bazë, iu dorëzuan respektivisht përfaqësuesit të Kryeministrisë dhe përfaqësuesit të Ministrisë së Brendshme, si pjesë e grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, caktuar tashmë për të dhënë konsulencën e tyre.

Pas diskutimesh të vazhdueshme të grupeve teknike të punës u konkludua që në dhjetor të saktësohej i gjithë dokumentacioni i nevojshëm teknik për të dy projektet, përfshi dhe llojin e certifikatave që duheshin kërkuar, si për kompanitë garuese dhe për vetë sistemet që do të zbatoheshin. Dokumentacioni përkatës mori vëmendjen e mbledhjeve të herpashershme të KQZ-së, dhe në fund të muajit dhjetor, me pjesmarrjen edhe të përfaqësuesve të partive politike, KQZ me Vendim Nr.23 miratoi procedurën prokurore që do të përdorej për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV. Mbështetur në përcaktimet e ligjit për prokurimin publik, në kushtet e një kohe të kufizuar, KQZ vendosi të përdorë "procedurë me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës".

Për të bërë të mundur një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe transparencën e nevojshme, njoftimi për zhvillimin e këtyre procedurave ju adresua jo vetëm kompanive që kishin shprehur zyrtarisht interes pranë KQZ-së, por u botua në 4 gazeta vendase dhe në median ndërkombëtare. Gjithashtu njoftimi së bashku me dokumentet standarte të këtyre procedurave u publikua edhe në

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





faqen zyrtare të KQZ-së, me qëllim krijimin e lehtësirave për pjesëmarësit. Puna për përzgjedhjen e kompanive mori kohën e nevojshme edhe në fillim të vitit 2013. Për zbatimin e projektin SEN është shpallur kompania fituese, kompania spanjolle "Indra". Për projektin SEV procesi i negociatave me kompanitë e përzgjedhura mbi bazën e projektit teknik të përshtatshëm është drejt fundit, dhe së shpejti do të shpallet fituesi.

V.2 Plani orientues i veprimeve

Megjithëse ishte i pritshëm procesi i ndryshimit të Kodit Zgjedhor, KQZ filloi punën për përgatitjen për zgjedhje, kohë më parë, për të garantuar një standart të përmirësuar të përgatitjes dhe administrimit të tyre më të mirë, gjë që në vijimësi do të kontribuonte në standartin e vetë procesit zgjedhor në tërësi.

Me daljen e Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7841, datë 3.12.2012 për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, KQZ gjatë vitit 2012 miratoi disa akte të rëndësishme për këto zgjedhje. Një nga vendimmarrjet e rëndësishme të KQZ-së është dhe miratimi i planit orientues të veprimeve.

Në këtë kuadër, administrata e KQZ-së përgatiti një plan paraprak të punës për vitin 2013, i cili përkon me vit zgjedhor. Ky plan me formatimin e ri të strukturës së KQZ-së, ju paraqit asaj për miratim. KQZ pas një diskutimi dhe debatimi edhe me përfaqësues të partive politike, miratoi me vendimin nr. 17, datë 06.12.2012 "Planin orientues të veprimeve të KQZ-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013".

Veprimet që duhet të ndërmerren nga KQZ, burojnë nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe janë një aplikim i tyre në praktikë. Miratimi i këtij plani orientues veprimesh përbën një dokument bazë për nisjen e veprimtarisë së KQZ-së, në përputhje me përcaktimet e nenit 21 të Kodit Zgjedhor. Në këtë mënyrë duke ndërtuar një kalendar të veprimeve të veta KQZ, synonte që procesi përgatitor zgjedhor të vendosej në kornizë ligjore në një sistem të organizuar dhe jo rastësor.

Në këtë plan parashikohen në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet që lidhen me përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvendin, duke përcaktuar afatet përkatëse për çdo veprimtari të parashikuar. Miratimi i një plani të tillë është një vendimarrje me mjaft vlerë në procesin përgatitor të zgjedhjeve.

V.3 Aktet e miratuara në KQZ gjatë vitit 2012, për zgjedhjet për Kuvend datë 23 Qershor 2013

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





V.3/1 Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013.

Një nga detyrat e ngarkuara në Kodin Zgjedhor për KQZ-në është përcaktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore. Neni 75 e në vijim i Kodit Zgjedhor parashikon procedurat që duhet të ndiqen për këtë proces. KQZ procedoi me njoftimin zyrtar të institucioneve të ngarkuara nga ligji në këtë drejtim, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrisë së Brendshme, për të paraqitur numrin e përgjithshëm të shtetasve dhe numrin e shtetasve për çdo qark, sipas Rregjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ministria e Brendshme i dërgoi KQZ-së të dhënat e kërkuara, duke theksuar që numri i shtetasve është i datës 7 nëntor 2012. Neni 76 pika 1 e Kodit Zgjedhor përcakton se " Si rregull 4 muaj para datës së fillimit të periudhës zgjedhore, që i paraprin fundit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me kërkesë të KQZ-së, dërgon numrin e përgjithshëm të shtetasve, për çdo qark, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile". Ndërsa pika 2 e të njëjtit nen përcakton se "Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e të dhënave, KQZ-ja kryen llogaritjen për caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 75 të këtij kodi dhe ia dërgon menjëherë Kuvendit".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në seancë plenare mori në shqyrtim në datë 23.11.2012 përlllogaritjet e bëra nga administrata e KQZ-së për ndarjen e mandateve, sipas të dhënave të ardhura në rrugë zyrtare nga institucionet përkatëse.

Ky projekt-akt i paraqitur, në bazë të urdhërimeve të Kodit Zgjedhor, për t'u miratuar duhet të merrte votën "pro" të paktën të 5 anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Projekt akti u hodh në votim dhe mori 4 vota "pro". Sipas Kodit Zgjedhor, mosvotimi "pro" konsiderohet si votim "kundër".

Referuar në përcaktimet e nenit 24 të Kodit Zgjedhor, pika 1/ë, ku përcaktohet se "Konsiderohen të miratuara, kur votojnë "pro" jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së vendimet, lidhur me:

ë) caktimin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas nenit 76 të Kodit ", mungesa e numrit të kërkuar ligjërisht të votave "pro" sjell si pasojë, që projekt-akti i paraqitur "Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013", të mos miratohet.

V.3/2 Miratimi i krijimit të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend 23 Qershor 2013.

Në bazë të Kodit Zgjedhor, neni 27, pika 5, "Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit,



Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore”.

Për zgjedhjet e Kuvendit të vitit 2009, në bazë të Kodit Zgjedhor, neni 180, ZAZ-të u miratuan nga Kuvendi si aneks i Kodit Zgjedhor. Sipas këtij aneksi, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në 66 ZAZ. Kodi Zgjedhor bazon mbi këtë ndarje ngritjen e KZAZ-ve, të cilat janë niveli i dytë i administratës zgjedhore me detyra shumë të rëndësishme në administrimin e procesit zgjedhor, dhe në mënyrë të posaçme, në lidhje me procedurat që ndiqen në vendin e numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve në nivel ZAZ-je.

Eksperienca e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009 dhe atyre vendore të vitit 2011, tregoi se ndarja në 66 ZAZ ishte e pamjaftueshme për të siguruar një administrim efikas dhe në kohë të të gjithë proceseve zgjedhore në kompetencë të KZAZ-ve dhe në mënyrë të veçantë, nuk siguroi një numërim efikas dhe të shpejtë dhe nxjerrje të rezultateve brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Kjo u konstatua në vonesat për dorëzimin e materialeve zgjedhore pas përfundimit të procesit të votimit që u reflektua në vonesë për fillimin e procesit të numërimit të votave, në vet numërimin e votave, tejzgjatjen e procesit të numërimit, mbingarkesën e punës për grupet e numërimit, tabelimin në shkelje të afatit ligjor dhe probleme të tjera, veçanërisht në vendet e numërimit të votave (VNV). Kjo mungesë efikasiteti, vonesa dhe mbingarkesa në numërim dhe vonesa në nxjerrjen e tabelave të rezultateve për çdo ZAZ u konstatua edhe nga raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve të viteve 2009 dhe 2011 të OSBE/ODIHR-it i cili bëri rekomandimet përkatëse për përmirësimin dhe rritjen e shpejtësisë së procesit të numërimit.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor të bëra nga Kuvendi në lidhje me ndryshimin e kriterëve për krijimin e ZAZ-ve, mosverifikimin e materialit zgjedhor të vendosur në kutinë e materialeve zgjedhore nga procedurat e numërimit dhe rritjen numrit të tryezave të numërimit për çdo VNV, tregon qartë që Kuvendi, në zbatim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR, ka patur si qëllim të posaçëm, shkurtimin maksimal të kohës së numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit brenda fateve ligjore, për ta sjellë këtë aspekt themelor të procesit në standartet ndërkombëtare, për shpalljen e shpejtë dhe në mënyrë transparente të rezultateve, si dhe një përmirësim të efikasitetit të të gjitha procedurave që janë kompetencë e KZAZ-ve.

Në nenin 180 të Kodit Zgjedhor përmendet se ZAZ-të e miratuara nga Kuvendi “do të mbeten në fuqi pas zgjedhjeve të vitit 2009, deri në rishikimin e tyre nga KQZ, në përputhje me nenin 27 të këtij Kodi”.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar, për zgjedhjet e Kuvendit 2013, KQZ duhet të bënte rishikimin e zonave të administrimit zgjedhor, në përputhje me kriteret e ndryshuara të nenit 27 të Kodit Zgjedhor, në mënyrë që të sigurohet dhe mirëadministrimi i procesit zgjedhor.

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





Duke aplikuar saktësisht dhe plotësisht kriteret për ngritjen e ZAZ-ve sipas pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 27 të Kodit Zgjedhor dhe bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për numrin e zgjedhësve, për Zgjedhjet për Kuvendin të vitin 2013, administrata e KQZ-së propozoi që numri i ZAZ-ve të bëhet 89. Kjo ndarje në një numër më të madh të ZAZ, jo vetëm është në përputhje me përcaktimet ligjore, por njëherazi siguron një administrim shumë më efikas të procesit zgjedhor nga niveli i dytë i administratës zgjedhore dhe mbi të gjitha, një numërim shumë më të shpejtë e transparent, në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Numërtimi i ZAZ u propozua të bëhet me anë të një numri dy shifror duke filluar me 01 duke siguruar përputhshmëri të numërtimit unik kombëtar të zonave të qendrave të votimit me numërtimin e ZAZ-ve, ku ZAZ-ja nr. 01 duhet të përmbajë zonat me numërtim fillestar të qendrave të votimit, e në vijim.

Projekt akti i paraqitur për miratim, i cili parashikonte ngritjen e 89 zonave të administrimit zgjedhor, megjithëse u konsiderua në përputhje me nenin 27 të Kodit Zgjedhor nga të shtatë anëtarët e KQZ-së, mori votat "pro" vetëm të katër prej tyre. Kodi Zgjedhor, në nenin 24, pika 1/f, përcakton se "konsiderohen të miratuara, kur votojnë "pro" jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së vendimet lidhur me:

f) caktimin e zonave të administrimit zgjedhor, sipas nenit 27 të Kodit Zgjedhor".

Në kushtet e mungesës së numrit të kërkuar ligjërisht të votave "pro", KQZ me vendimin nr. 20, datë 21.12.2012 vendosi, të mos miratojë ndarjen e re të Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin 2013.

Kundër këtij vendimi Partia Demokratike ushtroi të drejtën e ankimit në Kolegjin Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor, në përfundim të gjyqimit, me vendimin nr. 1, datë 03.01.2013 vendosi ndarjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor sipas propozimit të administratës së KQZ-së, në 89 ZAZ.

V.3/3 **Emërimi auditëve teknikien**

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor, përcaktojnë, ndër të tjera, edhe të drejtën e KQZ për të mbikqyrur procesin e hartimit të listave, nëpërmjet auditëve teknikien. Konkretisht referuar nenit 61 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve mbikqyr procesin e hartimit të listave duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Gjithashtu KQZ, nëpërmjet këtyre auditëve teknikien, do të kontrollojë funksionimin e sistemit elektronik të verifikimit të zgjedhësve (SEV), kjo sipas përcaktimeve të shtojcës III, seksioni 3, pika 2 dhe seksioni 4 të Kodit Zgjedhor.

Të drejtat, detyrat dhe kushtet e kontratës ndërmjet KQZ-së dhe auditëve teknikien, u përcaktuan në udhëzimin e miratuar nga KQZ-së nr.2, datë 28.12.2012. Pas këtij normimi, brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, jo më vonë se 30 ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve, KQZ emëroi me vendim dy auditët teknikien, të

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail:
infosec@cec.org.al





propozuar nga Kryetarja dhe Zv/kryetari, pas konsultimit me përfaqësuesit e partisë më të madhe të shumicës dhe asaj më të madhe të pakicës në KQZ.

V.3/4 **Miratimi i procedurës prokuruese që do të përdoret për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet teknologjike SEN dhe SEV, që do të aplikohen në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të urdhërimeve të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka detyrimin të zbatojë përdorimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23.06.2013.

Konsideruar se implementimi i këtyre dy teknologjive përbën risi në administrimin e zgjedhjeve, si dhe për vetë specifikat e tyre, u ngrit një Grup Pune i përbërë nga specialistë të administratës së KQZ-së, të asistuar edhe nga përfaqësues të AKSH-it dhe Ministrisë së Brendëshme, me qëllim përgatitjen e kërkesave bazë të projektim-zbatimit për të dy projektet, SEN dhe SEV.

Administrata e KQZ-së, në referim edhe të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimet, kishte planifikuar që specifikimet teknike për të dy projektet të realizoheshin nga një kompani e specializuar, shërbimi i së cilës do të prokurohej.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së kohës në dispozicion, që legjislacioni i prokurimit publik kërkon për procedurën e mësipërme, pas diskutimit edhe nga trupa e KQZ-së të kërkesave bazë për të dy projektet, u konkludua që administrata e KQZ-së të përgatisë specifikimet teknike duke synuar hartimin e një projekt-buxheti të bazuar mbi këto specifikime.

Grupi i punës, në përmbushje të kësaj detyre, arriti të definonte termat e referencës (kërkesat bazë, kërkesa kualifikuese) që do të përdoren në procedurat prokuruese për përzgjedhjen e shoqërive që do të realizojnë projektet SEN dhe SEV.

Në kushtet kur këto projekte do të realizohen për herë të parë në Shqipëri, nuk janë të përdorura gjerësisht në botë, Grupi i Punës u gjend në kushtet e pamundësisë për të gjetur mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit që do të përdoret në secilën nga këto procedura prokuruese të parashikuara nga VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

Në kushtet e mungesës së referimeve të përcaktuara në aktin ligjor sipërcituar, si dhe në limitet kohore në të cilat ndodhej, KQZ kontaktoi dhe zhvilloi takime me ekspertë të Agjensisë së Prokurimit Publik, si organi shtetëror i specializuar. KQZ, e detyruar të realizojë këtë detyrim ligjor në një afat shumë të ngushtë kohor, ndodhur në kushtet e nevojës ekstreme. Në përfundim, të konsulencës më të mirë me legjislacionin e prokurimit publik, por dhe me Agjensinë e Prokurimit Publik u përzgjedh **Procedura**

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





"negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës" sipas përcaktimeve në VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

V.3/5 **Miratimi i strukturës së personelit shtesë**

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, KQZ-ja miratoi me vendimin nr.21, datë 21.12.2012, strukturën e personelit shtesë dhe strukturën e pagave, për punonjës të kategorive të ndryshme që do të rekrutohen, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, që do të zhvillohen më datë 23 Qershor 2013. Në zbatim të këtij vendimi, KQZ do të punësojë: 385 punonjës të përkohshëm, nga të cilët 91 ndihmës specialistë dhe 294 punonjës mbështetës, si asistent të punonjësve të përhershëm të Administratës së KQZ-së.

Këto struktura që do të ngrihen, me këtë kontigjent punonjësish mbështetës, sipas detyrimeve kontraktore të ndërsjellta do të ndihmojë Administratën e KQZ-së, për funksionimin me kapacitet të plotë të burimeve njerëzore, për realizimin me efektivitet, korrektësi dhe profesionalizëm të detyrimeve ligjore të ngarkuara nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

V.3/6 **Përdorimi i kamerave regjistruese dhe monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave, në Zgjedhjen për Kuvendin 2013.**

KQZ me Vendim Nr.19, datë 21.12.2012, miratoi përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në Vendet e Numërimit të Votave (VNV) në zgjedhjet për Kuvendin 2013. Kodi Zgjedhor në nenin 94, pika 4, përcakton se, në vendin e numërimit të votave, KQZ-ja vendos për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi çdo tavolinë numërimi për regjistrimin e vlerësimit të çdo fletë votimi dhe transmetimin në kohë reale në monitorë (ekrane) të vendosur përballë vëzhguesve.

Përveç sa parashikon neni 94, pika 4, për të monitoruar procesin e numërimit të votave në çdo VNV, KQZ vendosi të realizojë edhe një sistem për të monitoruar procesin e numërimit të votave në çdo VNV, duke parë në kohë reale nga ambjentet e KQZ-së nëpërmjet monitorëve zhvillimin e procesit të numërimit në VNV.

Ky proces është përdorur për zgjedhjet për Kuvendin 2009 dhe ato Vendore 2011. KQZ disponon pajisjet kryesore të nevojshme për realizimin e tij, por në kuadër të rritjes së numrit të ZAZ-ve, do të shtohen pajisjet për 23 VNV-të e shtuara aktualisht.

V.3/7 **Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit, për zgjedhjet për kuvend, 23 Qershor 2013.**

Adresa:
Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.
+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail
infosec@cec.org.al





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISI QENDOR I ZGJEDHJEVE

KQZ ka miratuar **Udhëzimin Nr.1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet"**. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat, që duhet të ndiqen nga organet e qeverisjes vendore, gjatë procesit të ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes të qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet, si dhe dhënies së informacionit KQZ-së. Ky Udhëzim, pas botimit në Fleroren Zyrtare, iu dërgua me shpjegimet e nevojshme të gjithë kryetarëve të njësive vendore dhe prefektëve të qarqeve. KQZ po ndjek në vijimësi zbatimin e tij në kohë e me cilësi.

Adresa:

Pallati i Kongreseve,
Blvd. Dëshmoret e Kombit,
Tirane,

Tel./Fax.

+355 (4) 23 53 63

Website: www.cec.org.al

E-mail

infosec@cec.org.al

